



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada – Government*

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport - Ministry of Culture, Youth and Sport

---

## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NË MES

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT (MKRS)

&

DOKUFEST

---

Prishtinë më 15/05/2015

### Neni 1

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Dokufest janë pajtuar për implementimin e projektit: Funkcionalizimi i Kino Lumbardhit në Prizren

### Neni 2

Ky Memorandum i Mirëkuptimit lidhet ndërmjet palëve nënshkruese: Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Dokufest.

### Neni 3

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është implementimi i projektit: Funkcionalizimi i Kino Lumbardhit.

#### **Neni 4**

Palët do të bashkëpunojnë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e të gjitha fazave të punës dhe aktiviteteve lidhur me projektin e lart theksuar.

Palët pajtohen për obligimet dhe përgjegjësitë themelore lidhur me implementimin e suksesshëm të projektit me të gjitha komponentat dhe në veçanti mbi përdorimin e drejtë të burimeve financiare dhe në përputhje me miratimin paraprak të tyre.

MKRS dhe Dokufest bashkërisht do të definojnë dhe propozojnë edhe objektivat tjera të nevojshme që kanë të bëjnë me implementimin e projektit në përgjithësi.

Dokufest raporton drejtëpërdrejt në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore për zbatimin dhe realizimin e projektit në përgjithësi.

#### **Neni 5**

MKRS për realizimin e këtij projekti ndanë mjete financiare në shumën prej 6.704 € (Gjashtë Mijë e Shtatëqind e Katër Euro) ashtu si është e përcaktuar në kërkesën e shqyrtuar dhe miratuar.

#### **Neni 6**

Dokufest obligohet ti dorëzojë raportet periodike të punës dhe raportet financiare deri në përfundimin e projektit.

#### **Neni 7**

Palët pajtohen që kur është e nevojshme dhe e obligueshme me ligj, të zbatojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit ashtu siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik, të aplikueshëm në Kosovë.

#### **Neni 8**

Ne rast të mos zbatimit të pikave të këtij memorandumi të mirëkuptimit nga ndonjëra palë, memorandumi mund të ndërpritet brenda periudhës dy (2) mujore.

Ndërprerja e memorandumit të mirëkuptimit bëhet përmes njoftimit me shkrim për palën tjetër me një dëshmi të pranimit të këtij njoftimi.

Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të Fuqisë mbinatyrore-Vis maior dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante, për veprimet e mundshme që duhet ndërmarrë.

### Neni 9

Ky Memorandum i mirëkuptimit është përpiluar në katër (4) dokumente origjinale në gjuhën shqipe.

Për ndryshimet e mundshme eventuale, palët do të pajtohen gjithmonë duke u bazuar në këtë Memorandum.

Në rast të ndonjë mosmarrëveshje, kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë.

### Neni 10

Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese.

### PALËT NËNSHKRUERE:

**Veton FIRZI**



Sekretar i Përgjithshëm,  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



**Eroll BILIBANI**



Drejtor Ekzekutiv  
Dokufest